



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:040112

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06283676

C.nr.3224/23

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Gresa Haxhiavdyli duke vodusur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A. R. nga Gjakova, të cilin me autorizim e përfaqëson Kushtrim Bunjaku, avokat në Gjilan, Rr. "Skenderbeu" H-42, K-II, Nr.3 Gjilan, kundër të paditurit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Lagja e Spitalit, Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Vlerta Rudi Brovina – juriste, me objekt kontesti: kompensim i pagës se 13-të, jashtë seancës, me 11 tetor 2024, mori këtë;

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A. R. nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Prishtinë, që në emër të pagës së 13 (trembëdhjetë), për vitin 2020 t'ia paguaj shumën prej 425.00 euro, me kamatë prej 8% nga data e paraqitjes se padisë e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datë 27.12.2023, në këtë gjykatë ka parashtruar padi në të cilën ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie të punës se rregullt të e paditura, me kontratë në kohë të pacaktuar me detyrat e punës si Teknik Medicinal Në Laboratorin Biokimik Hematologjik. Ka shtuar se paditësi në bazë të listës se pagave, e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për vitin 2020, ka pagën bazë prej 425.00 euro, tutje ka theksuar se në

nenin 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të shëndetësisë e nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë se Republikës se Kosovës dhe Federatës se Sindikatave të Shëndetësisë se Kosovës, parashihet se “Punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës se 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”, e që dispozita e paracituar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës se 13 lind kur punëdhënësi nuk e përmbrush atë, ndërsa në asnjë mënyrë e paditura nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore, ku kjo është thënë edhe në mendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, për zbatimin e kontratës kolektive sektoriale lidhur me kërkesat e pagës se 13 në sektorin e shëndetësisë, 212/2023, të datës 09.10.2023. Me propozim për gjykatën që ta aprovoj kërkesepadinë e paditësit, ashtu që ta detyroj të paditurin në pagimin e shumës prej 425.00 euro në emër të pagës se 13, për vitin 2020 me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes se padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcenim të përmbarimit.

E paditura, përmes të autorizuarës se saj me datë 27.03.2024 në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, në të cilën ka theksuar se e kundërshtojmë kërkesepadinë e paditësit si të pabazuar, të parashkruar dhe të pathemeltë. Tujte ka parashtruar se padisë se paditësit i mungon baza ligjore, pasi që bëhet fjalë për kontratën kolektive sektoriale të shëndetësisë, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2021. Ka theksuar se sipas dispozitës se nenit 17 paragrafi 2 të KKS-së, e njëjta interpretohet duke u lidhur me ekzistimin e mundësisë për një shpërblim të tillë, siç ka paraparë edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin juridik me numër protokolli 212/2023, të datës 09.10.2023, andaj edhe i padituri SHSKUK si organizatë buxhetore ka pasur mungesë të buxhetit nder vite në kategoritë e pagave dhe mëditjeve, edhe përkundër planifikimeve, i njëjti asnjëherë nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat në paga dhe mëditje, ku në tremujorin e fundit TM3 të çdo viti, vazhdimisht ka pasur deficit në paga dhe është plotësuar nga Ministria e Financave për mbulimin e pagave të rregullta, siç provohet edhe nga njoftimi i lëshuar nga Drejtori Financiar i SHSKUK z. Enver Gashi, me numër protokolli 3823, i datës 21.12.2023. Po ashtu, ka parashtruar se edhe Spitali i Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë, si institucion shëndetësor i nivelit sekondar/dytësor nuk ka mundësi buxhetore të bëjë kompensimin e shpërblimit për pagën e 13, siç provohet edhe nga përgjigja në kërkesë me numër protokolli 3610, e datës 13.12.2023, e lëshuar nga U. D. i shefit të njësisë për buxhet dhe financa z. Murat Kursani. Me propozim për gjykatën që ta refuzoj kërkesepadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 399 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK) erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar për arsyet si në vijim:

Në mes të palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësi është i punësuar tek i padituri, përkatësisht në punët dhe detyrat Teknik Medicinal Në Laboratorin Biokimik Hematologjik, po ashtu nuk ishte kontestues se i njëjti realizon pagë mujore bazë prej 425.00 euro.

Kontestuese në këtë rast në mes palëve ishte se a i takon paditësit e drejta për kompensimin e pagës se 13 dhe se a ekzistojnë mundësitet buxhetore të te paditurit për pagimin e pagës së 13, kundrejt paditësit.

Kjo gjykatë gjeti se në këtë rast duhet të aplikohet Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, e datës 12.06.2018, e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë se Republikës se Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në aplikim nga data 11.06.2018 e deri me datë 10.06.2018, e cila në nenin 17 paragrafi 2 ka paraparë se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Në vlerësim të dispozitës se cekur si me lartë, kjo gjykatë vlerëson se dispozita nga neni 17 paragrafi 2 e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, në përmbajtje lidhet me mundësitet buxhetore të punëdhënësit, pra e njëjta dispozitë nuk është e karakterit detyrues, përjashtimisht efektin detyrues e merr në rast se punëdhënësi ka buxhet të mjaftueshëm për mbulimin e pagës se 13 (trembëdhjetë) për punëtorët e punësuar dhe që janë nën menaxhimin e tij. Pra, kjo e drejtë krijohet kur punëdhënësi (i padituri) nuk e përbush këtë obligim, ndërsa nuk arrin që të provoj me asnjë provë se nuk ka pasur mundësi buxhetore për një kompensim të tillë.

Kësisoj, i padituri me rastin e paraqitjes se përgjigjes në padi, gjykatës i ka dorëzuar edhe provën materiale, nga e cila dëshmohet edhe gjendja financiare e tij në raport me buxhetin e pranuar vjetor për paga dhe mëditje.

Nga njoftimi me numër 3823, i datës 21.12.2023, i lëshuar nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, përkatësisht nga Drejtori i Financiar z. Enver Gashi, vërtetohet se për

vitin 2020, buxheti fillestar i alokuar për paga dhe mëditje për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, ka qenë në shumë prej 57,191,921.00 euro, ku buxheti i shpenzuar për paga dhe mëditje ka qenë në shumë prej 76,250,921.00 euro, ndërsa përfundimisht si institucion ka qenë në deficit buxhetor në shumë prej 19,059,000.00 euro.

Pra, nga njoftimi i cekur me lartë, njoftim të cilin gjykata e vlerësoj të besueshëm dhe të plotë, marrë parasysh se i njëjti është i lëshuar po nga organi dhe personi kompetent lidhur me gjendjen buxhetore tek i padituri, u provua se mundësitetë buxhetore të te paditurit nuk kanë qenë qe e njëjta të veproj sipas dispozitës se nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë.

Andaj, gjykata kërkesëpadinë e paditësit në raport me pagën e 13 (trembëdhjetë) për vitin 2020, e refuzoj për shkak se i padituri nuk ka qenë në obligim në mungesë të mjeteve buxhetore.

Gjykata vendosi që këtë çështje kontestimore ta vendos jashtë seancës gjyqësore duke u mbështetur në nenin 399 të LPK-së, e cila parasheh që “*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”, si dhe duke u bazuar në praktikën e ndërtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (rasti Jussilia kundër Finlandës, nr.73053/01), e cila praktikë është obligim që të zbatohet nga Institucionet e Republikës së Kosovës, obligim i cili del nga neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh se “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.3224/23, me 11 tetor 2024

GJ Y Q T A R J A

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.